



**Republika e Kosovës / Republic of Kosovo**  
**Komuna - Municipality**  
**Hani i Elezit**



01/Nr. 839 /2023  
Data: 20.11.2023

**PROCESVERBAL I KOMITETIT PER KOMUNITET**

Nga mbledhja e dhjetë –X- për vitin 2023 i Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 30.10.2023 me fillim pune në ora 15:00 në sallën e takimeve. Kryesuesi konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Komunitete.

**RENDI I PUNËS**

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
- 2.Takim me Zyrtarët e Zyrës së Inspektorëve.
- 3.Takim me Zyrtarin e Zyrës për kthim.
- 4.Eventuale

**U MIRATUA RENDI I PUNËS**

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi thekson:-** lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin; nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U MIRATUA PROCESVERBALI NGA Mbledhja E KALUAR**

## 2. Takim me Zyrtarët e Zyrës së Inspektorëve.

**Kryesuesi** thekson:- A u janë derguar ftesa inspektorëve të tregëtis , inspektorit për qeshitje komunale dhe komunikacion ,pasi që nuk janë prezent , në mbledhje të kuvendit duhet të u jepet si vretje që nuk janë prezent në mbledhje . Un kisha pyetje rreth inspektimeve mbrenda vitit a ka pas fletparaqitje për shkelje të dispozitave ligjore në shitore në barnatore rreth qmimeve

**Zaim Bela** thekson: Un mendoj që edhe afati i skadimit tek produktet në market duhet të inspektohet sepse ka produkte qe nuk i shikojme dhe janë pa afat

**Hanumshahë Dibrani** thekson: Qytetaret kan treguar që ka pas raste në market ku qmimi në sektor ka qenë me zbritje ndersa ne arkë qmimi ka ndryshuar

## 3. Takim me Zyrtarin e Zyrës për kthim.

**Kryesuesi** thekson:-Kalojmë në pikën tjetër pasi që nuk është prezent

## 4. Te ndryshme

**Zaim Bela** thekson: lokalet tek kufini a është tenderi nga komuna apo nga ministria

**Resul Suma** thekson: Tender nga ministria . Un kam një shqetesim tek qent endacak me u bë një zgjidhje pasi që tash po erresohet me heret e fëmijet kthehen nga shkolla .

**Kryesuesi** thekson: Tek kyqja e rrugës së Dimces në magjistrale është një lokal ku pengon qasjen në rruge nuk mund të shihet a ka ndonjë vetur mendoj që ata gilindera nuk janë të vendosura në pronen e e tij dhe po rrezikon qytetaret .

Mbledhja perfundoi në 15:50

**Procesmbajtësja**  
**Sara Berisha**

